



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 1739 Prot.

Tiranë, më 12.12.2019

V E N D I M
Nr.182 dt. 12.12.2019

“Mbi paralajmërimin e institucionit Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të hetimit administrativ mbi gjendjen e marrëdhënieve në shërbimin civil, të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, si dhe të detyrave të lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2018”, ku shprehimisht është kërkuar: “Të shqyrtohen me prioritet rastet e individëve, pjesë e shërbimit civil në administratën qendrore dhe vendore, të cilët vazhdojnë marrëdhëniet e punës, megjithëse kanë arritur moshën e pensionit dhe duhet të kishin ndërprerë në kohë marrëdhëniet juridike dhe financiare”, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Për të kryer këtë detyrë, ndërmjet të tjerave, është kërkuar nga njësitë përgjegjëse në institucionet e përfshira në këtë proces, që të raportojnë në lidhje me ata nëpunës, të cilët megjithëse kanë plotësuar moshën e pensionit të pleqërisë, ende vazhdojnë marrëdhënien e punës në pozicione të shërbimit civil.

Në këtë proces është përfshirë edhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, institucion varësie i Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, i cili punëson nëpunës civil. Pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 14571/1 prot., datë 11.09.2019, ministria e linjës ka raportuar për institucionet e varësisë në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Për institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve punonjësit që plotësojnë këtë kusht, të evidentuar sipas pozicionit të punës dhe momentit të plotësimit të moshës për të përfituar pensionin e plotë të pleqërisë janë:

- ***** , “Përgjegjës” në Sektorin e Kontrollit, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DPT, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 30.06.2018;
- ***** , “Inspektor i Parë” në Sektorin e Kontrollit, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Shkodër, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 16.11.2018;
- ***** , “Inspektor i Dytë” në Sektorin e Detyrimeve të Papaguara, Drejtoria Rajonale Dibër, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 09.05.2019;
- ***** , “Inspektor i Parë” në Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 18.09.2019;
- ***** , “Specialist” Qendra e Pagesave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 19.09.2019;
- ***** , “Përgjegjës” në Sektorin e Analizës dhe Statistikës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 03.10.2019;
- ***** , “Inspektor” në Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, Drejtoria Rajonale Tiranë, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 01.09.2019;
- ***** , “Inspektor” në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Drejtoria Rajonale Tiranë, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 28.08.2019;
- ***** , “Inspektor” në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tiranë, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 29.09.2019;
- ***** , “Inspektor” në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tiranë, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 04.10.2019;
- ***** , “Inspektor i Parë” në Sektorin e Kontrollit, DTM, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 03.10.2019;
- ***** , “Inspektor” në Sektorin e Kontrollit Drejtoria Rajonale Elbasan, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 25.08.2019;
- ***** , “Inspektor” në Sektorin e Kontrollit, Drejtoria Rajonale Fier, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 03.11.2019;
- ***** , “Inspektor i Dytë” në Sektorin e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, Drejtoria Rajonale Korçë, ka plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 30.07.2019.

Nga verifikimi, konstatohet se, këta punonjës janë ende në marrëdhënie pune me institucionin.

Në lidhje me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, në përmbajtjen e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, evidentohen në mënyrë të shprehur rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, si edhe afati dhe organi që konstaton rrethanat, si më poshtë:

“1. Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon për shkak të ligjit kur:

- a) nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij;
- b) nëpunësi humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
- c) plotësohet moshja për pensionin e plotë të pleqërisë;
- ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;
- d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

2. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, konstatohet 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij nga:

- a) njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën;
- b) DAP-i për anëtarët e TND-së.”

Në këto kushte, plotësimi i moshës për pensionin e plotë të pleqërisë, në rrethanat e çështjes që po shqyrtohet, është një prej rasteve që parashikohet në pikën 1/c, të kësaj dispozite dhe për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësit ushtrojnë aktualisht detyrën, sipas pikës 2/a, të nenit të cituar më sipër, duhet të veprojë menjëherë duke e konstatuar këtë fakt, në një afat që në ligj është parashikuar 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij, si dhe duke i njoftuar ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, nëpunësve civilë:

*****, *****
*****, *****
***** dhe *****.

Pozicionet e punës të cilat do të mbeten të lira pas këtij veprimi, duhet të shpallen vakante, për t’u plotësuar, sipas procedurës dhe kërkesave të neneve 21, 22, 23 etj., të ligjit në fjalë.

Për të gjitha sa analizuam më sipër, bazuar në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe pikës 9, të nenit 16 të rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, si dhe pasqyrimin e akteve në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) për punonjësit e mëposhtëm:

- ***** , “Përgjegjës” në Sektorin e Kontrollit, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, DPT;
- ***** , “Inspektor i Parë” në Sektorin e Kontrollit, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Shkodër;
- ***** , “Inspektor i Dytë” në Sektorin e Detyrimeve të Papaguara, Drejtoria Rajonale Dibër;
- ***** , “Inspektor i Parë” në Drejtorinë e Rimbursimit të TVSH, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- ***** , “Specialist” Qendra e Pagesave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- ***** , “Përgjegjës” në Sektorin e Analizës dhe Statistikës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- ***** , “Inspektor” në Drejtorinë e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, Drejtoria Rajonale Tiranë;
- ***** , “Inspektor” në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Drejtoria Rajonale Tiranë;
- ***** , “Inspektor” në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tiranë;
- ***** , “Inspektor” në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tiranë;
- ***** , “Inspektor i Parë” në Sektorin e Kontrollit, DTM;
- ***** , “Inspektor” në Sektorin e Kontrollit Drejtoria Rajonale Elbasan;
- ***** , “Inspektor” në Sektorin e Kontrollit, Drejtoria Rajonale Fier;
- ***** , “Inspektor i Dytë” në Sektorin e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave, Drejtoria Rajonale Korçë.

2. Pozicionet respektive të punës, të raportohen pranë Departamentit të Administratës Publike si pozicione të lira dhe DAP të vijoje procesin për plotësimin e tyre sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.
3. Kryerja e veprimeve të mësipërme, duhet të bëhet brenda **15** ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, Njësia e Burimeve dhe Departamenti i Administratës Publike janë të detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të dërgojë aktet administrative të cilat vërtetojnë realizimin e detyrave.
5. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Komisioneri do të vijoje procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

6. Të njoftohet për këtë vendim Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Financës dhe Ekonomisë si dhe Departamenti i Administratës Publike.

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të njoftojë punonjësit për të cilët është urdhëruar përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për vendimin e Komisionerit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha